



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Nr.29/19
Datë: 22/07/2019

Në mbështetje të nenit 23 par.1 dhe 2 , neni 28 paragrafi 1 pika 1.7 pika 1.8 pika 1.10 neni 29 neni 34 neni 35 LIGJIT Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS si dhe Ligji për plotësim ndryshim i tij Nr. 04/L-226; Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në përbërje të: Valon Prestreshi - Kryetar, Ahmet Krasniqi - Zv. Kryetar, Fatime Haziri - Anëtare, Shaqir Morina Anëtar, në mbledhjen e mbajtur me datën **22 KORRIK 2019** jep këtë:

MENDIM PROFESIONAL

- I. **AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS (tutje ref. AUTORITETI) konstaton** se mos zbatimi i *Udhëzimit Administrativ i Ministrisë së Financave - Nr. 02/2018, për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike dhe Sistemeve Fiskale* e dobëson presionin konkurrues nga ana e **Administratës Tatimore e Kosovës** nisur nga gjendja aktuale e tregut e cila shpie në përforcimin e kompanive ekzistuese të cilat janë të licencuara dhe certifikuar dhe që kanë fuqi të madhe në tregun përkatës.
 - II. **AUTORITETI konsideron** se mos zbatimi i *Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018, për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike dhe Sistemeve Fiskale nga Administratës Tatimore e Kosovës* mund të shpie tek format e keqpërdorimit të pozitës dominuese, marrëveshjeve të ndaluara apo praktikave të bashkërenduara.
- ANDAJ**
- III. **AUTORITETI kërkon nga Administrata Tatimore e Kosovës**, që përmes komisionit profesional të ATK-së t'i përgatisë specifikat teknike dhe funksionale për certifikim të pajisjeve fiskale bazuar në *Udhëzimin Administrativ MF - Nr. 02/2018, për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike dhe Sistemeve Fiskale*.
 - IV. **Kërkojmë nga Administrata Tatimore e Kosovës** që në afatin prej **30 ditësh** ta zbatoj piken III të këtij dispozitivi.
 - V. Në të kundërtën Autoriteti Kosovar i Konkurrencës do të raportoj në Komisionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Zhvillim Ekonomik.

ARSYETIM

1. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për vlerësimin *ex post* ka analizuar rastin pasi që me datën 06.02.2019 ka pranuar ankesë nga operatori ekonomik Global Service EU Shpk. Pretendimet e ankuesit kanë të bëjnë kundër Administratës Tatimore të Kosovës lidhur me mos zbatimit e Udhëzimit Administrativ MF - Nr. 02/2018, për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike dhe Sistemeve Fiskale.
2. Gjatë shqyrtimit paraprak të dokumentacionit analizimit të rastit konsultimit të bazës ligjore, Ministria e Financave me datë 18.05.2018 ka nxjerr Udhëzimi Administrativ MF-Nr. 02/2018 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike dhe Sistemeve Fiskale. Administrata Tatimore e Kosovës sipas nenit 28 të UA ka pas për obligim ta zbatojë brenda (3) muajve nga hyrja në fuqi të përgatis planin e veprimit për zbatimin e saj dhe të njoftojë palët e prekura nga ky Udhëzim Administrativ.
3. Udhëzimi Administrativ MF-nr. 02/2018 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike dhe Sistemeve Fiskale, ka qenë në fuqi prej datës 30.08.2018. Administrata Tatimore e Kosovës është vonuar në implementimin e nenit 28, me të cilin ka krijuar pakënaqësi tek operatorët ekonomik, të cilit i është pamundësuar të instalojë pajisje të reja fiskale në tregun përkatës.
4. Tregu i pajisjeve të arkave fiskale është i koncentruar në dy-tri kompani të cilat e mbulojnë më shumë se 90% të tregut relevant. Një treg me përqendrim të lartë mund të shpie tek format e keqpërdorimit të pozitës dominuese, marrëveshjeve të ndaluara apo praktikave të bashkërenduara.
5. Tregu është i karakterizuar me barriera/pengesa administrative për operatorët e tjerë të licencuar për tu kyçur në ofrimin e shërbimeve, tregu është pothuajse i njëjtë edhe pse ka pasur hapje të tregut në licencimin e operatorëve të ri.
6. Efektet e pozitës oligopolistike vërehen pasi që nuk ka presion të jashtëm mbi operatorët ekzistues që afrojnë së bashku në tregun përkatës. Operatorët ekonomik nuk kanë mundësi t'i përzgjedhin pajisjet e arkave fiskale se çmimet e tyre janë të përafërta, pa presion konkurrues.
7. Transparenca në këtë treg është e ulët duke e dobësuar presionin konkurrues nga ana e kërkesës nisur nga gjendja aktuale e tregut e cila shpie në përforcimin e 2 ose 3 kompanive ekzistuese të cilat kanë fuqi të madhe në tregun përkatës. Në këtë rast ngulfatet konkurrenca, eliminohen, largohen, dekurajohen kompanitë tjera për shkak të këtyre barrierave.
8. Me kufizimin e ofrimit të shërbimeve të kompanive të licencuara në tregun përkatës, të pajisjeve elektronike dhe sistemeve fiskale, biznesit i privohet e drejta e zgjedhjes për marrjen e shërbimeve tek operatorët ekonomik të licencuar.
9. Certifikimi i operatorëve të ri ekonomik do t'i shpie kompanitë që të konkurrojnë duke ju përgjigjur presionit konkurrues, duke zbritur çmimet dhe duke ofruar shërbime më të mira për bizneset.

10. Cdo kufizim ligjor apo faktik i numrit të operatorëve të cilët janë potencial për tu angazhuar në një veprimtari në një treg të caktuar (*numerus clausus*) është e ndaluar me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, që konkurrentët /operatorët të mos kufizohen nëpërmjet kushteve dhe kriterëve, sepse për të pasur konkurrencë të mirëfilltë duhet që të ketë më shumë konkurrent në tregun relevant.
11. Pas asaj që u tha me lart, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës jep Mendimin Profesional, nga pikëpamja e rregullave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

**KOMISIONI
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS**


Ahmet Krasniqi
Zv. Kryetar


Valon Prestreshi
Kryetar


Fatime Haziri
Anëtare


Muhamed Krasniqi
Anëtar


Shaqir Morina
Anëtar

Me këtë Mendim Profesional, të njoftohet:

- Administrata Tatimore e Kosovës
- Operatori Ekonomik Global Service EU Shpk
- Arhivës